



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu



-III- Nr. I prot. 1066 Më Dt. 02.04.2025  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

# RAPORTI 3-MUJOR I PUNËS

JANAR, SHKURT, MARS 2025



2025

## DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

### Aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2025

- Ka përfunduar vlerësimi i punëtoreve gjatë kësaj periudhe (deri më 31 janar 2025);
- Ka pasur aktivitete me kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore, përveç pastrimit të rrugëve nga bora, kompanitë janë angazhuar në pastrimin e rrugëve nga mbeturinat;
- Është bërë krasitja e drunjve dekorativë në qytet dhe në vendbanime të tjera;
- Ka filluar ndërtimi i pritoreve për pritjen e udhëtarëve në qytet dhe pikat që janë përcaktuar në vendbanimet e komunës së Rahovecit, në përfundim të kësaj periudhe janë 16 pritore;
- Po vazhdon projekti i zgjerimit të kanalizimit sipas prioriteteve;
- Po vazhdon mirëmbajtja e rrugëve në zonën urbane, në përmirësimin e ujëmbledhësve dhe gropave të krijuara në rrugë;
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa ndërhyrje në rregullimin e shtyllave të ndriçimit publik, po ashtu ka pasur aktivitete në zgjerimin e ndriçimit publik;
- Kemi angazhuar stafin në bashkërendimin me drejtoritë e tjera në detyrat që janë dhënë në lirim të hapësirave publike dhe inkasimin e mjeteve në shfrytëzimin e këtyre pronave;
- Është bërë marrëveshja e re me K.R.U. "Gjakova" për investime të përbashkëta publike;
- Po vazhdon projekti i gropave bioseptike sipas programit të EU-së, projekte nga IPA, janë në përfundim 6 grupa septike;
- Po vazhdon projekti i rrugës 4-korsi, lot 1, në këtë periudhë ka përfunduar muri mbrojtës, janë në përfundim të dy lëshesave pllakore, si dhe gërmimi i rrugës në gjatësi 1.4 km;
- Në këtë periudhë është riasfaltuar rruga "Gzim Hamza-Piktori";
- Është bërë barazimi i rregullt i të hyrave në drejtori;
- Ka filluar mirëmbajtja e hapësirave publike, eliminimi i deponive ilegale, pastrimi i hapësirave publike;
- Ka përfunduar ndërtimi i trotuareve në rrugën "Ibrahim Rugova" në Rahovec;
- Ka filluar rregullimi i një pjese të rrugës ndërmjet dy fshatrave Vrajakë dhe Bratatin;
- Po vazhdon projekti i ndërtimit të rrugës në Krushë të Madhe, "rruga e Drinit".

## Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2025:

---

- Sfidat e Drejtorisë janë kërkesat e shumta për ndërtimin e rrugëve lokale, si dhe për rrugë dytësore dhe të pakategorizuara;
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka përcjellë gjatë këtyre viteve janë mbeturinat e amvisërisë dhe ato inerte që fatkeqësisht hidhen kudo, ku krijohen deponi ilegale, Komuna e Rahovecit çdo vit mirëmban hapësirat publike, por ato prapë hidhen kudo;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e K.R.U. “Gjakova”.
- Rregullimi dhe furnizimi me energji elektrike, rigjenerimi i rrjetit të ri dhe kërkesa të shumta që adresohen nga qytetarët.

Drejtori i DShP-së

Përparim Krasniqi

